



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:064900

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05749476

KPPP.nr. 1004/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Raiffesien Bank Kosovë (RBKO), me seli në Prishtinë, rr. "Robert Doll", nr. 99, kundër debitorëve: 1. "Korabi Company" Sh.P.K., me numër unik identifikues 810690182 dhe seli në Vushtrri; 2. I.A. me numër personal ... dhe adresë në Vushtrri, rr. "N.D. dhe F.D.", dhe; 3. E.A. me numër personal ... dhe adresë në Vushtrri, rr. "N.D. dhe F.D.", duke vendosur sipas prapësimit të debitorit "Korabi Company" Sh.P.K., ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 236/23, i lejuar me datë 12.06.2023, nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit "Korabi Company" Sh.P.K., me numër unik identifikues 810690182 dhe seli në Vushtrri, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 236/23, i lejuar me datë 12.06.2023, nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovë, mbi bazën e dokumentit përmbartimor, Marrëveshjes mbi Pengun e datës 24.03.2021, të regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas konfirmimit nr. R-20210325-305, për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja mbi kredinë nr. 200728643, e datës 24.03.2021, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 236/23, të datës 12.06.2023, me të cilin janë detyruar debitorët që, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, të paguajnë shumën prej EUR 18,934.73, me kamatë të rregullt

dhe kamatëvonesë, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, përmes bllokimit të xhirollogarive bankare të debitorëve, apo përmes sekuestrimit të kolateralit të lënë peng.

Debitori Korabi Company, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, me arsyetim se dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk është i përshtatshëm për përbarim. Ka shtuar se organi përbarues ka lejuar urdhrin në bazë të nje dokumenti të kundërligjshëm dhe se nuk janë përmbushur kushtet për lejimin e përbarimit. Poashtu, ka theksuar se vlera e borxhit të arritur për pagesë është shumë më e vogël krahasuar me vlerën si në propozimin për përbarim e cila është në shumë prej EUR 1,450.00. Në fund, ka shtuar se dokumenti mbi të cilin është lejuar urdhri ka elemente fiktive dhe tendencë nga kreditor për pasurim pa bazë. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim për shkak se nuk janë të mbështetura në prova në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se pretendimet e debitorit rreth kontestimit të borxhit janë të pa bazuara për arsye se kontratat e kredisë janë komutative ku palët në momentin e nënshkrimit të tyre janë të njoftuar në mënyrë të detajuar me të drejtat dhe detyrimet që derivojnë nga këto kontrata, si dhe me interesin apo kamatëvonesën në momentin e rënies në vonesë të kredi marrësit. Tutje, ka theksuar se tendenca e debitorit është prolongimi i procedurës përbarimore ngase pretendimet e të njëjtit janë të pabazuara dhe kanë për qëllim vetëm shmangien nga detyrimet ndaj kreditorit. Ndërsa, në fund ka shtuar se kreditori nuk mund të pajiset me dokument origjinal të regjistrimit të pengut ngase certifikata për regjistrin e pengut lëshohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në mënyrë elektronike dhe si e tillë shërben si titull përbarimor dhe mund të përdoret pranë organeve gjyqësore. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përbarimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa me nenin 5, paragrafi 2 të Ligjit

05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se dokument përmbartues paraqet: “...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”. Në anën tjetër, me nenin 27, paragrafi 1 të LPP-së, është përcaktuar se “Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.

Tutje, sipas nenit 38, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, *Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit. 2. Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.*

Gjykata, duke ju referuar dispozitave të cekura si më lartë, gjeti se dokumenti, përkatësisht Marrëveshjes mbi Pengun e datës 24.03.2021, për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja mbi kredinë nr. 200728643, e datës 24.03.2021, e mbi bazën e së cilave është paraqitur propozimi për përmbartim nga ana e kreditorit dhe është lejuar urdhri përmbartimor nga ana e përmbartuesit privat, nuk janë deponuar në origjinale apo kopje të vërtetuara siç kërkohet me nenin 38 të LPP-së.

Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përmbartim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmban të meta ngase në propozim nuk është treguar dokumenti origjinal apo kopje e vërtetuar mbi bazën e së cilit është iniciuar procedura përmbartimore, ashtu siç kërkohet me nenin 38, paragrafi 1 të LPP-së, me të cilin parashihet se propozimi për përmbartim, ndër të tjera, duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet, dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar.

Në anë tjetër, sipas dispozitës nga neni 43, paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se “Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbartueshmërisë së nxjerrë nga përmbartuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbartuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se

nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.

Andaj, nga të lartcekurat gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit përmbarimor, dhe në këtë drejtim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit përmbarimor.

Gjykata mori parasysh se dokumenti përmbarimor, përkatësisht Marrëveshjet e pengut mbi bazë e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor mbajnë vulën e saktësisë së lëshuar nga ana e kreditorit, mirëpo gjeti se vendosja e vulës së tillë nga ana e kreditorit të njëjtave dokumente nuk ia jep tiparet e dokumentit të vërtetuar nga origjinali, ngase për vërtetësinë e kopjes nga origjinale kompetent është organi noterial dhe atë në kuptim të nenit 47.1 të Ligjit për noterinë.

Gjykata vlerëson se është detyrim ligjor i përmbaruesit privat që, para lejimi të urdhrit përmbarimor, të vlerësoj nëse propozimi për përmbarim i paraqitur nga kreditori i plotëson kërkesat nga neni 38, paragrafi 1 i LPP-së, dhe në rast se propozimi nuk është paraqitur konform kësaj dispozite, atëherë duhet që të veproj sipas nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, lidhur me nenin 102, paragrafi 1 të LPK-së, duke e ftuar kreditorin që të bëjë plotësimin e propozimit për përmbarim duke bashkangjitur origjinalin apo kopjen e vërtetuar të dokumentit përmbarimor brenda afatit të paraparë ligjor.

Gjykata mori parasysh se pretendimet e kreditorit se certifikata e regjistrimit të pengut gjenerohet në mënyrë elektronike dhe se e njëjta përbën titull ekzekutiv, mirëpo gjykata gjen se në kuptim të dispozitës nga neni 5.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dokument përmbarimor është përcaktuar Marrëveshja mbi Pengun, ndërsa regjistrimi i pengut është vetëm kusht dhe në këtë drejtim propozimit për përmbarim është dashur që ti bashkangjitet në origjinal dokumenti përmbarimor, përkatësisht Marrëveshja e Pengut, ndërsa certifikata mbi regjistrimin e pengut të shërbej vetëm si provë se që pengu është i regjistruar pranë regjistrimit përkatës.

Poashtu, gjykata pati parasysh se Marrëveshja e Pengut mban vulën e saktësisë së lëshuar nga ana e kreditorit, mirëpo gjeti se vendosja e vulës së tillë nga ana e kreditorit të njëjtit dokument

nuk ia jep tiparet e dokumentit të vërtetuar nga origjinali, ngase për vërtetësinë e kopjes nga origjinale kompetent është organi noterial dhe atë në kuptim të nenit 47.1 të Ligjit për noterinë.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1004/23, datë 29.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.